



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-24-0361

***Në ankesën e***

***Paditësi/Ankuesi***

**B A** fshati G, Podujevë, i përfaqësuar në shkallën e dytë nga avokati **B I**, Prishtinë.

**Kundër**

**E paditura**

**NSH, FAN "Zahir Pajaziti"** Podujevë (në likuidim), të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakërishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtar, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2725 të datës 11 prill 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 19 shtator 2024, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

- 1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**
- 2. Anulohet Aktvendimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2725 të datës 11 prill 2024.**
- 3. Lënda kthehet në rishqyrtim në shkallën e I-rë të DHPGJS-së tek gjyqtari përkatës.**
- 4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

## **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 14 prill 2014, Dhoma e Posacme e Gjykatës Supreme, përmes postës së rregullte të Podujevës me numër R-1135058, ka pranuar zarfin mirëpo pa aktpërcjellës në emër të paditësit. Paditësi me këtë zarfë ka dërguar:

- *Vendimin e Autoritetit të Likuidimit me numër PRN046-0263 të datës 26 mars 2014 me të cilin është refuzuar kërkesa e paditësit për kompenzimi për paga të papaguara në shumë prej 1,600.00 euro, për periudhën Dhjetor 2002 deri Dhjetor 2004*
- *Vendimin e AL-së me numër PRN046-0264, me të cilin është refuzuar kërkesa e paditësit për kompensimin e 3 pagave të papaguara në shume prej 660 euro nga Janar 2006 deri Mars 2006 si dhe,*
- *Vendimin e AL-së me numër PRN046-0262, me të cilin është refuzuar kërkesa e paditësit për kompensim për ndërperje të parakohshme të Punës në shumë të paspecifikuar*
- *Kopjen e Librezës së punës, Listën e rrogave të mbetura borgj dhe Njoftimin për ndërperjen e marrëdhënies së punës me datën 24 mars 2006.*

Me datë 13 dhjetor 2023, shkalla e I-rë ka lëshuar Urdhër për paditësin dhe prej tij është kërkuar që brenda 7 ditëve nga dita e pranimi të këtij urdhri, të dorëzojë Ankesën ndaj Vendimeve të kundërshtuara të cilat i ka dorëzuar së bashku me zarfin R-1135058, mirëpo pa parashtresë në emër të parashtresit.

Pas dështimit të dorëzim-pranimi të dokumentit, në bazë të nenit 26, paragrafi 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, nenit 116.5 dhe 116.6 të LPK-së, Urdhri i datës 7 shkurt 2024 ka qëndruar në Tabelë të Shpalljeve nga data 1 mars 2024 deri më 11 mars 2024.

Me datë 11 prill 2024, shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktvendimin C-IV-14-2725 ankesën e hedhë poshtë si të papranueshme. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se pasi që shqyrtoi ankesën e dorëzuar dhe shkresat e tjera të lëndës konstatoi se ankesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme. Neni 36 paragrafi

2.6 i Ligjit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (ligji nr. 06/L-086) parasheh se një padi/ankesë konsiderohet e pranueshme nëse është bashkëlidhur edhe një kopje e aktit juridik kundër apo ndaj të cilit është paraqitur kërkesa/ankesa. Edhe përkundër tentimeve të gjykatës, me anë të urdhëresës, ankuesi nuk e ka përmbushur kushtin ligjor. Parashtruesi ka dorëzuar zarfin R-1135058 mirëpo pa parashtrësë në emër të parashtruesit si dhe ka bashkangjitur Vendimet e Autoritetit të Likuidimit, me të cilat janë refuzuar kërkesat e tij si dhe provat tjera shtesë. Edhe përkundër tentimeve të gjykatës me anë të urdhëresës dhe qëndrimit të urdhrit në Tabelë të Shpalljeve, ankuesi nuk e ka dorëzuar Ankesën ndaj Vendimeve të bashkangjitura të Autoritetit të Likuidimit. Parashtruesit gjykata i bën me dije se sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë t'i paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*). Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku në pajtim me nenin 33 paragrafi 1 dhe nenin 36 paragrafi 2 pika 2.3 e Ligjit për Dhomën e Posaçme vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me datë 07 maj 2024, paditësi (në tekstin e mëtejme ankuesi) në DHPGJS ka dorëzuar një ankesë kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-14-2725 të datës 11 prill 2024, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet Aktvendimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rishqyrtim. Për më tepër në ankesë paditësi ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë gabimisht ka aplikuar dispozitat e nenit 116.5 dhe nenit 116.6 të LPK-së, në bazë të cilave dispozita e ka arsyetuar hedhjen poshtë të ankesës së të pa pranueshme. Tutje paditësi pohon se gjykata para se të afishon Urdhrin në Tabelën e shpalljeve, nuk i ka shterë të gjitha mundësit ligjore që i ka në bazë të LPK-së, për të dorëzuar Urdhrin. Tutje paditësi pohon se raporti i postës është i pa saktë, dhe se ai ka adresën e njëjtë të dhënë në ankesë. Ai pohon se Aktvendimin e shkallës së I-rë e ka pranuar në të njëjtën adresë në fshatin Gllamnik ku edhe jeton. Ai shton se si është e mundur që Aktvendimin e ka

pranuar në këtë adresë, ndërsa shkresat tjera të gjykatës nuk i ka pranuar në të njëjtën adresë. Tutje paditësi pohon se gjykata nuk ka arritur ti kryej obligimet e veta ligjore, ndërsa nxjerr Aktvendim të pa bazuar në ligj, me të cilën e hedhë poshtë ankesën si të papranueshme.

Me datë 04 korrik 2024, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës së paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja e kundërshton ankesën e paditësit si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se në mbrojtjen në padi ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktvendimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të anulohet, dhe lënda të kthehet në rishqyrtim.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 14 prill 2014, e ka dorëzuar një pliko në DHPGJS, pa ndonjë akt përcjellës-pa ankesë. Me këtë pliko ai ka dërguar: Vendimin e Autoritetit të Likuidimit me numër PRN046-0263 të datës 26 mars 2014 me të cilin është refuzuar kërkesa e paditësit për kompensimi për paga të papaguara në shumë prej 1,600.00 euro, për periudhën Dhjetor 2002 deri Dhjetor

2004, Vendimin e AL-së me numër PRN046-0264, me të cilin është refuzuar kërkesa e paditësit për kompensimin e 3 pagave të papaguara në shume prej 660 euro nga Janar 2006 deri Mars 2006 si dhe, Vendimin e AL-së me numër PRN046-0262, me të cilin është refuzuar kërkesa e paditësit për kompensim për ndërperje të parakohshme të Punës në shumë të paspecifikuar, Kopjen e Librezës së punës, Listën e rrogave të mbetura borgj dhe Njoftimin për ndërperjen e marrëdhënies së punës me datën 24 mars 2006.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Urdhrin e datës 13 dhjetor 2023 ka kërkuar nga paditësi të dërgon ankesën si dhe prova shtesë. Urdhri është tentuar ti dorëzohet paditësit me datë 20 dhjetor 2023 dhe me datë 28 shkurt 2024, mirëpo ky Urdhër nuk ka mundur të dorëzohet, nga se raporti i postës thotë ky person është i pa njohur, dhe kërkohet të jepet edhe emëri i prindit.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në adresën e njëjtë në fshatin Gllamnik, e ka pranuar Aktvendimin e ankimuar. Ky paditës në shkallën e I-rë të DHPGJS-së nuk ishte i përfaqësuar nga Avokati, ai vetëm në shkallën e dytë angazhon Avokat për ta përfaqësuar në procedurë.

Rrjedhimisht mund të konstatohet se paditësi banon në të njëjtën adresë, dhe ai nuk ka bërë ndërrim të adresës. Shkalla e I-rë Urdhrin e ka afishuar edhe në Tabelën e shpalljeve nga data 01.03.2024 deri 11.03. 2024.

Kolegji i Apelit konstaton se për shkak të lëshimeve evidente të postës, nuk ka mundur të dorëzohet Urdhri i shkallës së I-rë. Lëshimet e tilla nuk mund të shkojnë në dëme të paditësit. Komunikimi me paditësin dele që nuk ka qenë i rregullt, mu për shkak të lëshimeve të postës.

Andaj në këtë rast mund të konstatohet se nuk ka dorëzim të rregullt ligjor të Urdhrit, dhe rrjedhimisht pasojat ligjore të mos përmbushjes së Urdhrit, nuk mund të jenë në dëme të paditësit.

Andaj nga këto arsye, ankesa e paditësit aprovohet si e bazuar, anulohet Aktvendimi i ankimuar dhe lënda kthehet në rishqyrtim. Paditësit duhet ti jepet edhe një rast që të rregullon ankesën në bazë të dispozitave përkatëse të LDHP-së.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesi nuk ngarkohet me taksë gjyqësore, për shkak se mungon ankesa në shkallën e I-rë, dhe nuk dihet saktë shuma e tij e kërkesës për paga, e që kjo ishte arsye, që atij Zyra e regjistrimit nuk i ka dërguar Vërejtjen për taksë në procedurën ankimore.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së 19 shtator 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_